

Përshëndetje të nderuar,

KALLXO.com ka pranuar reagimin e Komisionit vlerësues të procesit të përzgjedhjes së kryesuesit dhe dy anëtarëve të bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRÉ), në përbërje të Rifat Blakaj - kryesues; Makfirete Dibrani - anëtare dhe Enis Spahiu - anëtar.

Reagimi i Komisionit vlerësues ka ardhur për artikullin *“Prapaskenat e zgjedhjes së bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji”*, saktësisht për pjesën e artikullit për ndryshimin e pikëve nga anëtarët e Komisionit vlerësues për disa nga kandidatët e intervistuar për pozitën kryesues dhe dy anëtarë të bordit të ZRRÉ-së.

KALLXO.com në këtë artikull nuk i ka publikuar emrat e anëtarëve të Komisionit vlerësues, se kush të cili kandidat i ka ndryshuar pikët për hir të korrektësisë ndaj anëtarëve të këtij Komisioni.

Pas reagimit të Komisionit vlerësues, KALLXO.com në përgjigjen e saj ndaj këtij reagimi është e shtyrë që t'i publikojë emrat e anëtarëve të Komisionit që i kanë ndryshuar pikët të secili nga kandidatët, që nga dita e parë e deri në ditën e fundit të intervistimit të kandidatëve për kryesues dhe atyre për dy anëtarë të bordit të ZRRÉ-së.

Ju lutem, shihni më poshtë përgjigjen e plotë dhe sqarimet në reagimin tuaj. Kjo përgjigje së bashku me reagimin tuaj do të publikohet në KALLXO.com.

Reagimi i Komisionit vlerësues të procesit të përzgjedhjes përmes akuzave paranojake dhe leximit me qëllim të shtrembëruar të raportit të KALLXO.com, tenton të shpërqendrojë vëmendjen e opinionit publik nga pasqyrimi i saktë dhe strikt i të gjitha veprimeve procedurale që ka ndjekur dhe nuk ka ndjekur komisioni gjatë procesit të rekrutimit të kryesuesit dhe dy anëtarëve të bordit të ZRRÉ-së.

Jemi të shqetësuar me të pavërtetat që janë në reagimin e Komisionit vlerësues për anëtarë dhe kryesues të bordit të ZRRÉ-së. Në këtë reagim, anëtarët e Komisionit vlerësues kanë thënë se në artikull janë *“...disa informata të pavërteta lidhur me punën e Komisionit rekomandues...”*, por në fakt të pavërteta janë konstatimet e anëtarëve të Komisionit vlerësues.

Fillimisht në reagimin e Komisionit është cituar gabimisht teksti i publikuar në KALLXO.com - *“Ky shkrim ngrit një akuzë të rëndë ndaj anëtarëve të Komisionit, ku thuhet se kishte raste kur pikët e kandidatëve janë ndryshuar në fund të ditës së intervistës pa ndonjë diskutim, si dhe aludohet në ndryshim të pikëve të kandidatëve tjerë me ndonjë tendencë.”*

Në reagimin e Komisionit është shtuar pjesa *“si dhe aludohet në ndryshim të pikëve të kandidatëve tjerë me ndonjë tendencë”*. Kjo pjesë e fjalisë nuk është publikuar në KALLXO.com,

por është konstatim i komisionit që me ose pa qëllim është në reagim si pjesë e citatit nga teksti i publikuar. Gjithashtu, në artikull nuk ka asnjë aludim, por janë renditur faktet.

Më poshtë janë të gjitha pikët e ndryshuara nga anëtarët e Komisionit vlerësues.

Pozita: Kryesues i bordit të ZRrE-së

Sipas metodologjisë së paracaktuar nga Komisioni vlerësues, kandidatët janë vlerësuar menjëherë pas intervistimit, praktikë që aplikohet edhe nga ekspertët e angazhuar nga Ambasada britanike. Anëtarët e Komisionit vlerësues pas intervistimit të një kandidati në mënyrë autonome e bëjnë vlerësimin e tyre. Vlerësimi bëhet në atë mënyrë që për secilën pyetje kandidatët vlerësohen nga 1 në 10 pikë. Përveç poentimit, anëtarët e Komisionit janë të obliguar që të mbajnë shënime për performancën e kandidatit dhe përgjigjet e tij. Pas përmbylljes së vlerësimit, anëtarët e Komisionit e bëjnë kumtimin e pikëve për secilën përgjigje që e ka dhënë një kandidat. Në fund, nxirren pikët e dhëna nga një anëtar i Komisionit vlerësues dhe më pas kalkulohen pikët mesatare që ka marrë kandidati nga tre anëtarët e Komisionit vlerësues. Pas kumtimit të pikëve nga secili anëtar i Komisionit vlerësues, nëse ka pasur diskrepancë në poentim zakonisht është diskutuar nga anëtarët e Komisionit. Ka pasur raste kur pas diskutimeve, anëtarët e Komisionit kanë reflektuar duke bërë ndryshim të pikëve për një kandidat. Por, ka pasur raste kur gjithë procesi i poentimit është përfunduar, ndërsa ndryshimi i pikëve ka ndodhur në fund të ditës. Pra, nuk janë ndryshuar pikët pas kumtimit të tyre dhe diskutimit në mes të anëtarëve, por janë ndryshuar në fund të ditës kur janë përfunduar intervistat me të gjithë kandidatët e paraparë për intervistë në ditën e caktuar. Më poshtë janë rastet konkrete të ndryshimit të pikëve.

- Anëtari i Komisionit, **Enis Spahiu** i ka ndryshuar pikët në 4 kompetenca të kandidati **Armend Ymeri**. Ndryshimi i pikëve ka ndodhur menjëherë pas intervistimit të Ymerit. Pikët e ndryshuara: nga 3 në 4, nga 4 në 5, nga 4 në 6 dhe nga 4 në 5. Ai tha se e ka poentu kandidatin duke menduar pikët maksimale 8, por në fakt pikët maksimale ishin deri në 10. Gjithashtu, ai tha ky ndryshim i pikëve është edhe reflektim pas diskutimit me dy anëtarët e tjerë të Komisionit për shkak se ai nuk e njuh mirë sektorin e energjisë.

- Në fund të ditës së parë të intervistimit (pas intervistimit të gjashtë kandidatëve të ditës së parë), anëtarja e Komisionit, **Makfirete Dibrani** i ka ndryshuar pikët apo e ka ulur vlerësimin për kandidatin **Astrit Saraqini**, i cili është intervistuar i dyti me radhë. Pra, ndryshimi i pikëve nga Dibrani është bërë në fund të ditës, jo pas intervistimit të kandidatit nga 8 kompetenca sa kanë qenë gjithsej, janë ndryshuar pikët në 5 kompetenca. Nga 8 pikë sa e kishte poentuar në fillim, Dibrani i ka ulur në 7; pastaj nga 8 i ka ulur 6 pikë; nga 7 pikë është bërë 6; nga 8 i ka bërë 7 pikë dhe nga 7 pikë sa i kishte dhënë në fillim e ka ndryshuar në 6 pikë. Pra nga vlerësimi total prej 56 pikëve, Dibrani e ka ulur në 50 pikë. Nga mesatarja prej 58 pikëve, kandidatit i ka rënë vlerësimi në 56. Me 58 pikë, Saraqini do të renditej si kandidatë i 4- të.

- **Makfirete Dibrani** i ka ndryshuar pikët apo i ka rritur pikët për kandidatin **Vehbi Sofiu**, në fund të ditës së parë të intervistimit. Sofiu ishte është intervistuar i treti me radhë nga 6 kandidatë që janë intervistuar në atë ditë. Dibrani tha “ky ka qenë ma i mirë se këta të tjerët për këtë arsye po e ndryshoj”. Nga 8 kompetenca sa kanë qenë, Dibrani i ka rritur pikët në dy kompetenca, në të dyja, nga 8 pikë i ka bërë 9. Rritja e pikëve për Sofiun, rriti edhe mesataren e tij nga 60.6 në 61.3 pikë. Ndryshimi i pikëve nuk ka ndikuar në ngritjen e tij në renditjen finale.

- Te kandidati **Edmond Nulleshi**, kryesuesi i Komisionit, **Rifat Blakaj** ka ndryshuar pikët në njërin nga tetë kompetencat. Vlerësimin në këtë kompetencë ai e ka ulur nga 7 në 5 pikë. Ndryshimi i pikëve është bërë pas intervistimit të kandidatit Edmon Nulleshi.

Pozita: Dy anëtarë të bordit të ZRrE-së

- Te kandidati **Arsim Sherifi**, anëtarja e Komisionit, **Makfirete Dibrani** ka ndryshuar pikët në njërin nga kompetencat nga 7 në 8 me arsyetimin që Sherifi ka dhënë një mendim ndryshe nga të gjithë kandidatët e tjerë. Te kandidati Sherifi ka diskrepancë të vlerësimit mes Dibranit, Spahiut me Blakajn. Vlerësimi total i Blakajt për Sherifin është - 41 pikë, e Spahiut – 60 pikë dhe e Dibranit – 65 pikë. Blakaj ka një dallim prej 19 pikësh me Spahiun dhe 24 pikësh me Dibrantin. Te kandidati Arsim Sherifi, ndryshimi i pikëve është bërë pas intervistimit të tij.

- Te kandidati **Idriz Ferati**, kryesuesi i Komisionit, **Rifat Blakaj** ka ndryshuar apo ka zvogëluar pikët në dy kompetenca. Në të dy kompetencat pikët janë ulur nga 7 në 5. Vlerësimi i përgjithshëm i Blakajt është ulur nga 54 pikë në 52 pikë. Blakaj i ka ndryshuar pikët pas intervistimit të kandidatit Ferati, pasi u pa diskrepanca në vlerësim mes tre anëtarëve të Komisionit vlerësues. Blakaj i ka ndryshuar pikët duke thënë se edhe paraprakisht ka pasur dilema për pikët në këto dy kompetenca ku i ka zvogëluar pikët.

Për fund.

KALLXO.com nuk ka përdorur tone akuze apo aludime për tendencën e anëtarëve të komisionit që kanë ndryshuar pikët e tyre, mirëpo vetëm ka pasqyruar në mënyrë kronologjike lëvizjet e pikëve, arsyetimin për lëvizjen e pikëve dhe momentin kur janë lëvizur pikët - krejt kjo me qëllim të pasqyrohet pajtueshmëria e procedurës së ndjekur nga komisioni karshi procedurave që i ndjekë BDO.

Pra, KALLXO.com ka treguar se ndryshimi i pikëve është bërë pas diskutimeve në mes të anëtarëve të Komisionit vlerësues në rastet kur kishte diskrepanca, por gjithashtu ka treguar që kishte raste kur ndryshimet janë bërë në fund të ditës së intervistimit.

Shkrimi i publikuar në KALLXO.com nuk tenton të njollojë punën e këtij Komisioni e as nuk tenton të diskreditojë punën e bërë nga Komisioni, por e ka pasqyruar atë që ka ndodhur në këtë proces.

KALLXO.com i ka pasqyruar në shkrim praktikat e mira që i ka ndjekë Komisioni, sidomos ato që i aplikon BDO-ja për: mënyrën e intervistimit, kohën e barabartë që i është dhënë të gjithë kandidatëve, poentimin autonom që është bërë, por edhe për diskutimet pas poentimit.

Por, njëkohësisht ka raportuar edhe për pjesën e ndryshimit të pikëve që është bërë në fund të ditës pa dhënë asnjë arsytim se pse po bëhet ky ndryshim i pikëve. Gjithashtu ka raportuar edhe vendimin e Komisionit të Ankesave për kthimin në garë të kandidatëve të eliminuar nga Komisioni vlerësues.

Reagimi i Komisionit vlerësues

Reagim nga Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për pozitën e Kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të ZRrE-së ndaj shkrimit “Prapaskenat e zgjedhjes së bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji”

Në shkrimin e publikuar në portalin online kallxo.com me datë 02.08.2021, me titull “Prapaskenat e zgjedhjes së bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji”, tek nën titulli “Ndryshimi i pikëve nga anëtarët e Komisionit” janë reflektuar disa informata të pavërteta lidhur me punën e Komisionit Rekomandues për udhëheqjen dhe zhvillimin e procedurës së rekrutimit për Kryesues dhe Anëtar të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji nga monitoruesja e këtij procesi, znj. Dorentina Kastrati, gazetare e këtij portali. Ky shkrim ngrit një akuzë të rëndë ndaj anëtarëve të Komisionit, ku thuhet se kishte raste kur pikët e kandidatëve janë ndryshuar në fund të ditës së intervistës pa ndonjë diskutim, si dhe aludohet në ndryshim të pikëve të kandidatëve tjerë me ndonjë tendencë.

Ne, anëtarët e këtij Komisioni (Rifat Blakaj – Kryesues, Makfirete Dibrani – Anëtare dhe Enis Spahiu – Anëtar) njëzëri dëshirojmë t’i sqarojmë opinionit të gjerë publik që ky konstatim i dhënë në këtë shkrim nuk qëndron.

Komisioni në fillim të punës së tij është dakorduar mbi disa parime dhe ato janë respektuar nga Komisioni. Njëra nga ato ka qenë që vlerësimi i kandidatëve të bëhet menjëherë pas përfundimit të intervistës për secilin kandidat. Në asnjë rast, pa asnjë përjashtim, Komisioni nuk ka bërë ndryshime në pikët e kandidatëve në fund të ditës së intervistës. Pas çdo interviste, Komisioni ka pasur kohën e caktuar për vlerësim individual dhe për diskutim lidhur me poentimin. Pra, pa përjashtim, të gjitha poentimet e kandidatëve kanë përfunduar pas intervistave individuale, dhe listat e nënshkruara janë mbledhë dhe vendosur në dollap dhe nuk janë prekur deri në fund të procesit kur janë dorëzuar së bashku me raportin dhe dokumentet tjera. Për këtë, opinioni i gjerë mund të konsultohet edhe me zyrtarët e Komunitetit të Energjisë që kanë monitoruar procesin e intervistimit të kandidatëve për kryesues të ZRrE-së.

Në anën tjetër, parim i pranuar nga Komisioni ishte edhe diskutimi i poenëve të kandidatëve në rast të ndonjë diskrepancë të madhe. Çdo herë, pa përjashtim, pas përfundimit të poentimeve individuale, anëtarët e Komisionit kanë kumtuar poenët e tyre dhe, në rast të diskrepancave, poenët janë diskutuar, për çfarë komisioni është dakorduar që më parë. Në këto diskutime,

anëtarët e Komisionit i janë kthyer shënimeve të tyre dhe janë munduar të argumentojnë qëndrimet e tyre dhe më pas është zhvilluar debat në mes të anëtarëve të Komisionit. Kjo teknikë nuk ka synuar ndonjë ndryshim arbitrar të poenëve të kandidatëve. Përkundrazi, është synuar poentim sa më objektiv. Pra, në asnjë rast nuk është bërë ndonjë ndryshim arbitrar i poenëve, e aq më pak duke synuar ndonjë ndryshim në rangimin e tyre, siç aludohet në shkrim.

Pra, çuditërisht, në këtë shkrim në njërin anë reflektohet metodologjia e punës së Komisionit, përfshirë këtu edhe (citim) “Poentimi është bërë në mënyrë autonome nga anëtarët e Komisionit vlerësues ndërsa në rastet kur kishte diskrepanca të mëdha është diskutuar dhe argumentuar nga anëtarët e Komisionit vlerësues”, ndërsa në anën tjetër ka akuza se ka pasur ndryshim të poentimit (citim) për kandidatë të caktuar në fund të ditës së intervistimit dhe pa ndonjë diskutim në fund të ditës së intervistimit dhe pa ndonjë diskutim.”

Pa paragjykuar në qëllimin e gazetares znj. Dorentina Kastrati, vlerësojmë sa ky shkrim tenton të njolloso punën e këtij Komisioni. Andaj, ne, anëtarët e këtij Komisioni i drejtohem portalit kallxo.com, ku kërkojmë reflektim lidhur me këtë çështje. Jemi të vetëdijshëm që ka pasur qindra procese anëmbanë shtetit tonë ku në mënyrë flagrante janë shkelur parimet e meritokracisë, ku edhe ne kemi duartrokatur reagimet e gazetarëve. Por, kemi frikë që në këtë rast po ndodh e kundërta dhe po tentohet të diskreditohet një punë e bërë nga Komisioni në mënyrën më objektive të mundshme dhe pa hile, me dijeninë dhe qëllimin tonë më të mirë.